

BENEFITET E MASTERCARD WORLD CREDIT



Duke ju falenderuar që zgjidhni Bankën Credins për kryerjen e shërbimeve tuaja financiare, duam të theksojmë dhe një herë angazhimin e Bankës për të ofruar produkte dhe shërbime të përshtatshme për nevojat tuaja. Më poshtë ju informojmë për benefitet që përfitoni me Mastercard World Credit lëshuar nga Credins Bank.

- Zëvendësim të kartës në raste emergjente (Emergency Card Replacement):** Ju do të përfitoni nga shërbimi i zëvendësimit të kartës në rast humbje, vjedhje apo dëmtimi. Kërkesa do të procesohet gjatë orarit zyrtar të punës së bankës/Call Center-it dhe karta do t'ju dërgohet nëpërmjet një partneri Postar të sigurt, në adresën të cilën ju do të deklaroni.
- Dërgimi i parave Cash në raste emergjente (Emergency Cash Advance):** Ju do të përfitoni nga opsioni i dërgimit të parave Cash në rast emergjence. Dërgimi i fondeve do të bëhet nëpërmjet MoneyGram. Shuma që do t'ju transferohet do të jetë Disponibiliteti i shumës së kartës.
- Sigurim Jete dhe Shëndeti në Udhëtim:** Ju do të përfitoni falas Sigurim Jete dhe Shëndeti në Udhëtim nga kompania e sigurimeve Sicred. Informacionet për policën e sigurimit do t'ju dorëzohen në momentin e dorëzimit të kartës.
- Program benefitesh Sociale ose Shëndetësore:** Ju do të përfitoni mundësinë e regjistrimit në "Healthy Blog", nëpërmjet kredencialeve që do të gjenden në informacionin e kartës Master Card World, përdoruesi: "emër mbiemër" dhe fjalëkalimi: janë 4 shifrat e fundit të kartës suaj MasterCard.

Nëpërmjet regjistrimit në këtë blog ju përfitoni falas këshillim dietik online (e-mail/chat), udhëzues për ushqimin stinor (blog), statistika të personalizuar; kalkulator BMI (Indeksi i Peshës Trupore) dhe BMR (Norma Bazë e Metabolizmit); këshillues për aktivitetin sportiv, bazuar mbi të dhënat personale; këshillim për ushqimin e fëmijëve, sipas grupmoshave.

- Programi i Besnikërisë:** Ju do të bëheni pjesë e programit të Besnikërisë "Pentagram" dhe do të përfitoni pikë bazuar në përdorimin e kartës. Nëpërmjet Master Card World Credit ju do të përfitoni 6 pikë për çdo 1,000 lekë të shpenzuara. Në fund të muajit Banka do të kalkulojë numrin përkatës të pikëve që ju keni fituar. Pikët e fituara do të përkthehen në benefite, kupona dhuratë, mallra apo shërbime, milje udhëtimi, para cash në kartë etj.